



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.998/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Valon Totaj dhe Arsim Hamzaj - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit G.TH. nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. P.P. nga Gjakova, kundër të paditurve F.TH. nga fshati ..., Komuna e Gjakovës dhe Komuna e Gjakovës, e përfaqësuar nga V.SH., për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, me vlerë të kontestit 200 €, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.105/2008, të datës 29.09.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **03.11.2020**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditësit G.TH. nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.105/2008, të datës 29.09.2017, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.105/2008, të datës 29.09.2017, në pikën I të dispozitivit, e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit G.TH., me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se i njëjti është pronar i paluajtshmërisë së evidentuar si parcelë nr...., me kulturë kullosë e klasit të III, në sipërfaqe prej ... ha, sipas fletëposedimit nr.200 ZK ..., ashtu që detyrohen të paditurit F.TH. nga fshati ..., Komuna e Gjakovës dhe Komuna e Gjakovës, që paditësit t'ia njohin këtë të drejtë, si dhe t'ia kompensojnë të gjitha shpenzimet procedurale, të gjitha në aat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit, si tërësisht të pabazuar. Ndërsa, në pikën II të dispozitivit, janë obliguar palët që secila t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë paditësi, përmes të autorizuarit të tij, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me këtë ankesë, paditësi i ka propozuar Gjykatës së Apelit që

aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë, ose të njëjtin, ta prishë dhe t'ia kthejë lëndën në rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Pala e paditur Komuna e Gjakovës ka paraqitur përgjigje në ankesë, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të refuzojë si të pathemeltë ankesën e paditësit, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetojë në tërësi.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

-Ankesa e paditësit është e **pathemeltë**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me padinë e parashtruar në gjykatën e shkallës së parë, të datës 03.03.2008, ka kërkuar që të vërtetohet se i njëjti është pronar i paluajtshmërisë së evidentuar si parcelë nr...., me kulturë kullosë e klasit të III, në sipërfaqe prej ... ha, sipas fletëposedimit nr.200 ZK ..., ashtu që detyrohen të paditurit F.TH. nga fshati ..., Komuna e Gjakovës dhe Komuna e Gjakovës, që paditësit t'ia njohin këtë të drejtë, si dhe t'ia kompensojnë të gjitha shpenzimet procedurale, të gjitha në aat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit.

Gjykata e shkallës së parë, në bazë të kësaj padie, ka zhvilluar procedurën kontestimore dhe pas administrimit të provave materiale të përshkruara në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, vendosi që të refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, mes tjerash, ka theksuar se pabazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditësit, e ka konstatuar me anë të provave të administruara si më lartë, të cilave ua fali besimin e plotë, është provuar fakti se paditësi me asnjë provë të vetme nuk ka arritur të provojë faktin se të njëjtit i takon e drejta e pronësisë mbi ngastrën kontestuese nr.... ZK Ndërsa përkundër dekalrimit të paditurës së parë F.TH. se këtë ngastrë ja ka shitur paditësit në vitin 1981 dhe për këtë e pranon kërkesëpadinë e tij, gjykata nuk e ka pranuar një gjë të tillë, konform nenit 3 të LPK-së, pasi që me aktvendimin V.nr.965/82, të datës 25.05.1983, është bërë pjesëtimi fizik i ngastrës dhe në paragrafin III të dispozitivit të kësaj aktvendimi është vendosur që *“të evidentohet si pronë shoqërore parcela ... në sipërfaqe prej 0.03.69 ha”*, ndërsa që nga ky vit (*edhe në bazë të raportit të ekspertit të gjeodezisë*) kjo ngastër evidentohet si pronë shoqërore në emër të PSH Rrugët Publike. Në anën tjetër, në bazë të nenit 29 të LMTHPJ-së nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë me parashkrim fitues në pronë shoqërore, ndërsa edhe paditësi nuk ka arritur të argumentojë se këtë ngastër e ka blerë nga e paditura e parë dhe posedimin e kësaj prone. Vendimin e marrë mbi shpenzimet procedurale, gjykata e shkallës së parë, e arsyetoi me nenin 452.4 të LPK-së (*më gjerësisht sikurse në arsyetim të aktgjykimit të atakuar*).

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182.2, pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe, Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, në bazë të dispozitës së

nenin 194 të LPK-së, e po ashtu, ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Në këtë kuptim, gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes rreth kërkesëpadisë së paditësit, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore, ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, e si rezultat i kësaj, drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, për të cilat arsye, aktgjykimi i atakuar është dashur të vërtetohet në tërësi. Gjithashtu, edhe dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke krijuar kështu harmoni logjike e juridike mes dispozitivit e arsyetimit. Përkatësisht, i njëjti është hartuar në përputhje të plotë me nenin 160 të LPK-së. Gjukata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për mungesën e themelsisë së kërkesëpadisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë, ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Për këto arsye, refuzohen si të pabazuara pretendimet ankimore sipas të cilave gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të tilla, me rastin e hartimit të vendimit gjyqësor.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore sipas të cilave gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar si duhet gjendjen faktike dhe se nuk ka trajtuar siç duhet pretendimet e paditësit, të shprehura në kërkesëpadi. Nga provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë, përkatësisht, nga fletëposedimi kadastral nr...., datë 07.02.2008, certifikatës së pronësisë nr...., datë 04.07.2017 dhe nga ekspertiza e gjeodezisë e hartuar nga ekspertët B.M. dhe G.R., konstatohet se ngastra kadastrale kontestuese nr. ..., në vendin e quajtur "...", me kulturë kullosë e klasit të tretë, në sipërfaqe prej ... ha ZK ..., evidentohet si pronë shoqërore në emër të P.SH Rrugë Publike dhe me këtë të drejtë, kjo palë ndërgjyqëse evidentohet që nga viti 1983. Duke qenë se paluajtshmëria kontestuese është pronë shoqërore, e asnjëherë nuk ka qenë e evidentuar në emër të paditësit, i njëjti, nuk mund të fitojë pronësinë në të, as me parashkrim fitues, e as me ndonjë bazë tjetër juridike, siç ka pretenduar në ankesën e parashtruar.

Fillimisht, gjykatës së shkallës së parë nuk i është prezantuar asnjë provë se paditësi ka hyrë në posedim të ngastrës kadastrale kontestuese në mënyrë të ligjshme dhe mbi ndonjë bazë të vlefshme juridike. Duke qenë se toka që nga viti 1983, ishte gjithmonë në emër të P.SH Rrugë Publike, e asnjëherë në emër të vet paditësit, një kusht i tillë, nuk është përmbushur, andaj edhe gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, të bazuar në një të drejtë të tillë. Edhe pse mirëbesimi paraqet një gjendje përmes së cilës ai në vetvete supozohet se ekziston, një pronë e tillë shoqërore, gëzon mbrojtje dhe pozitë të veçantë në të drejtën aktuale pozitive, andaj çështja e mirëbesimit në këtë rast duhet të provohet qartazi dhe dukshëm, pa lënë vend për mëdyshje. Ashtu siç me të drejtë ka theksuar edhe gjykata e shkallës së parë, me asnjë provë nuk është vërtetuar se paditësit i takon e drejta e pronësisë e evidentuar si pronë shoqërore.

Më tutje, refuzohen si të pabaza edhe pretendimet ankimore që bazohen në shitblerjen e tokës nga paditësi nga e paditura e parë F.TH., pasi që pranimi i kërkesëpadisë nga kjo e fundit, me të drejtë nuk është pranuar nga gjykata e shkallës së parë, pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë disponim të palejueshëm të të drejtave, e që është e ndaluar me nenin 3 të LPK-së. Pavarësisht deklaratave të dëshmitarëve që mund të kenë pohuar një gjë të tillë (*e që me të drejtë gjykata e shkallës së parë nuk i ka falur besimin të njëjtave*), gjykatës gjithnjë i duhen prova

konkrete që vërtetojnë një fakt të tillë, sidomos kur kemi të bëjmë me çështje të ndjeshme të pronësisë si kjo. Në rastin konkret, edhe nëse do të ekzistonte një kontratë e tillë, e njëjta nuk mund të shërbejë si bazë për vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën shoqërore, e aq më pak kur e njëjta është lidhur me jo pronarin.

Nga të gjitha të lartëcekurat, rrjedh se nuk ekziston asnjë bazë ligjore mbi të cilën paditësi do të mund të kishte fituar të drejtën e pronësisë mbi paluajtshmërinë kontestuese. Të qenit pronë shoqërore, e bën këtë paluajtshmëri një send me një trajtim ligjor më të veçantë, në të cilin, për t'u fituar e drejta e pronësisë, duhet të plotësohen kushtet ligjore në mënyrë kumulative, pa asnjë mëdyshje mbi ligjshmërinë dhe mirëbesimin në posedim dhe shfrytëzim të tokës. Kështu, në mungesë, të bazës ligjore apo të veprimit juridik të vlefshëm, për fitimin e të drejtës së pronësisë, gjykata e shkallës së parë, me të drejta ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara nga neni 29 LMTHPJ-së, për fitimin e një të drejte të tillë nga ana e paditësit.

Meqë aktgjykimi i atakuar është vërtetuar në tërësi, automatikisht vërtetohet edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, me të cilin janë obliguar të dyja palët për mbulimin e shpenzimeve të veta procedurale, sipas nenit 452.4 të LPK-së.

Gjykata e Apelit i mori parasysh edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore të palës paditëse, por të njëjtat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe nga kjo që është vendosur.

Nga të lartëcekurat, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195.1, pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.998/18, datë 03.11.2020

Kryetari i Kolegjit,
Lumni Sallauka